

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“3B Integrated Solutions” shpk**

**KREU I  
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1:**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

- 1) Sot, më 01.06.2024, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “3B Integrated Solutions” shpk.
- 2) Themeluesit e shoqërisë janë:
  - a) RENIS BAKALLI, atësia KUJTIM, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës me numër BA7055185, me numër personal identifikimi K00401046L i datëlindjes 01.04.2000, lindur në Fushë- Krujë dhe banues në Fushë- Krujë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Neni 2:**

**Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
  - Shitja e dyerve të brendshme dhe të jashtme si dhe të produkteve të lidhura me dyert.
  - Tregtimi i materialeve të mobilerisë dhe aksesorëve të lidhura me mobilerinë.
  - Prodhim dhe tregtimi brenda dhe jashtë vendit me shumice dhe pakice i mobiljeve të gjitha llojeve për objekte banimi, objekte publike, të sistemit shkollor, administrativ, shëndetësor, të biznesit, me baze druri dhe kombinime dru, metal, plastike, tekstil.
  - Prodhimi dhe tregtimi brenda dhe jashtë vendit me shumice dhe pakice i karrigeve metalike, karrigeve prej druri dhe të kombinuara, mobiljeve të buta.
  - Prodhimi dhe tregtimi brenda dhe jashtë vendit me shumice dhe pakice i dyerve me material drusor dhe metalik të brendshme, dyerve të blinduara, dyerve antipanik, dyerve special për sistemin shëndetësor, institucione e biznese.
  - Prodhimi dhe tregtimi i materialeve të ndertimit. Prodhimi dhe tregtimi brenda dhe jashtë vendit me shumice dhe pakice i materialeve, aparaturave, paisje elektrike, agregateve dhe percjellesave elektrike të gjitha llojeve.
  - Ndertimi i objekteve të banimit, objekteve administrative, shkollore, shëndetësor, objekteve industrial dhe të biznesit.
  - Import&eksport dhe tregtimi me shumice dhe pakice i prodhimeve industriale, prodhimeve ushqimore, produkteve bujqesore, artikujve elektroshtepiake dhe teknologjise se informacionit dhe komunikimit, materialeve ndertimi, plehrave kimike, materiale dhe artikuj të gjitha llojeve dhe pjese kembimit të tyre, shërbime servisi automjetesh, import eksport tregtimin me shumice i vajrave lubrifikante e karburanteve.
  - Kryerja e shërbimeve të auditimit brenda dhe jashtë vendit pa kufizime gjeografike (kontroll financiar, shërbime konsulence të bazuara në ekspertiza kontabile, menaxhim i risqeve të informacionit, shërbime të kontrollit të menaxhimit), asistencë kontabile, regjistrim të dhënash kontabël, konsulencë në fushën fiskale, shërbime të konsulencës financiare. Rekuperim i kompanive në vështirësi, investigim detyrimesh dhe të drejtash në situata problemesh midis palëve, shërbime për transaksionet e blerjes dhe shitjes së kapitaleve, konsulencë manaxheriale dhe organizative, rekrutim dhe trajnim profesional si dhe shërbime të lidhura me to. Shoqëria mund të kryejë të

gjitha aktivitetet që do të konsiderohen të nevojshme për përmbushjen e objektit të saj.

- Aktivitetet e shitjes dhe blerjes me pakice dhe shumice të verave dhe pijeve alkoolike në përgjithësi; Veprimtari të lidhura ose të ngjashme për realizimin e objektit të shoqërisë. Shoqëria, për zbatimin e objektit të saj, me përgjithësisht, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të domosdoshëm për përmbushjen e qëllimit të shoqërisë, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- Aktivitet në fushën e mjedisit për mbrojtjen dhe/ose përmirësimin si dhe rehabilitimin e kushteve të mjedisit rrethues; përpunimin e mbetjeve urbane, toksike, radioaktive, teknologjike si dhe mbetje të çdo lloji tjetër.
- Prodhim të të gjitha materialeve të ndërtimit dhe aksesoreve në ndërtim, prodhimet e konstruksioneve metalike, plastike, të drurit dhe kombinime të ndryshme të tyre. Prodhimin e dyerve, dritareve duralumin plastike dhe strukturale.
- Konsulencë teknike në fusha të ndryshme, projektim, supervizion, menaxhimet dhe studimet e të gjitha llojeve, realizimi i kontratave, marrëveshjeve, ekspertize, planbizneseve, projekte zhvillimi dhe studime të efektiviteteve ekonomike.
- Administrim fondesh dhe/ose investimesh;
- Shërbime në fushën e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme duke përfshirë pa u kufizuar qiradhenie, administrim, menaxhim, mirëmbajtje, riparim, ndërmjetësim etj., për vetë shoqërinë apo të Tretet.
- Shërbime të marketingut, promovimit dhe reklamimit për aktivitetet e veta ose për të tjerë.
- Shërbime të ndryshme në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe agroperpunimit si grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore, të agrikulturës, të agropërpunimit.
- Veprimtari në fushën e mbështetjes së bashkëpunimit të fermerëve, kooperativave bujqësore dhe organizmave të tjera lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me sektorët e agrokultures, agroindustrisë, agroturizmit, mjedisit, energjisë së rinovueshme, etj.

### **Neni 3:**

#### **Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.
- 2) Ky afat mund të ndryshohet në çdo kohë me vendim të asamblesë së ortakëve.
- 3) Shoqëria mund të priset në çdo moment me vendim të asamblesë së ortakëve.

### **Neni 4:**

#### **Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në L Punëtori, blloku nr 3, pallati nr 9, kati nr 4, apartamenti nr 1, Fushë- Krujë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.
- 3) Transferimi i selisë së shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendim të Ortakut të vetëm të Shoqërisë.
- 4) Shoqëria ka të drejtë të operojë me zyra, filiale, dege apo agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë apo dhe jashtë vendit.

## **KREU II KAPITALI**

*Faqe 2 e 8*

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (Njëqind Mije) Lekë dhe është i ndarë në 1 (Një) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
  - a) Ortaku themelues RENIS BAKALLI, zotërues i 1 (Një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (Njëqind Mije) Lekë, që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6:**  
**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- 1) Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 2) Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**

- 1) Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
  - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 3) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**  
**Organi Vendimmarrës**

- 1) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj
- 3) Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
  - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 4) Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
  - 5) Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
  - 6) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### **Neni 9**

#### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

- 1) Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 2) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### **Neni 10**

#### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme me miratimin e ortakut të vetëm.

### **Neni 11**

#### **Marrja e vendimeve**

- 1) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
  - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve
  - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

- 3) Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKR për te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

### **Neni 12** **Përfashtimi nga e drejta e votës**

- 1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13** **Administrimi**

- 1) Administratori i shoqërisë emërohet RENIS BAKALLI, atësia KUJTIM, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës me numër BA7055185, me numër personal identifikimi K00401046L i datëlindjes 01.04.2000, lindur në Fushë- Krujë dhe banues në Fushë-Krujë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.
- 2) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

### **Neni 14** **Kompetencat e Administratorëve**

- 1) Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
  - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 2) Administratorët janë te detyruar te thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
  - a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

- b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
  - 4) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 15**

### **Përgjegjësitë e Administratorit**

- 1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 2) Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare“, administratori detyrohet:
  - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
  - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 4) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 5) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
- 6) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:
  - a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.
- 7) Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
- 8) Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

## **KREU IV VITI FINANCIAR, EKSPERTET**

### **Neni 16 Viti Financiar**

- 1) Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### **Neni 17 Ekspertet**

- 1) Eksperti ka për detyre që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tilla i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 2) Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'jua paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **KREU V PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

### **Neni 18 Prishja dhe likuidimi**

- 1) Shpërndarje ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë:
  - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) me vendim të Asamblesë se Ortakeve;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin.
  - e) me vendim të gjykatës;
- 2) Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

- 3) Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguesve, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- 5) Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 19**

#### **Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja**

- 1) Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

#### **Neni 20**

#### **Baza Ligjore**

- 1) Akti i themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe kanë karakter të detyrueshem, ndersa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to plotësohen nga legjislacioni shqiptar.
- 2) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 3) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 21**

#### **Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"3B Integrated Solutions" shpk**

**RENIS BAKALLI**

